

VENDIM
Nr.401, datë 22.4.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË
SHËRBIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 3 të vendimit nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen edhe emërtesat:

“-Drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), drejtorët e drejtorive, përgjegjësit e sektorëve dhe specialistët në DSIK.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha